

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “SPY SPEAKEASY” SH.P.K

Sot në Tiranë, më datë 07/02/2024, hartuan dhe nënshkruan këtë akt-themelimi, palët e mëposhtme:

- Znj. Ingrid Lalike, shtetase shqiptar, e datëlindjes 02.04.1991, lindur në Vlorë, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 035946611 dhe me nr. personal J15402097A,
- Z. Dejvi Lalike, shtetas shqiptar, i datëlindjes 02.06.1994, lindur në Vlorë, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 032974303 dhe me nr. personal J40602091U dhe
- Z. Ermand Hasalliu, shtetas shqiptar, i datëlindjes 10.10.1993, lindur në Kavajë, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 038565171 dhe me nr. personal J31010134I Në vijim palët referuar si “**Themeluesit**”.

Themeluesit janë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë ata ranë dakort me hartimin e këtij Akti Themelimi, në përputhje me legjislacionin shqiptar, sipas kushteve të mëposhtme.

Kushte paraprake

Duke marrë në konsideratë se ne, Themeluesit, duam të ushtrojmë veprimtari ekonomike dhe kemi për qëllim arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë dhe bashkuar kontributet tona në një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me qëllimin final për të prodhuar dhe ndarë përfitim ekonomik, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe të dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

- Ne, të nënshkruarit, Znj. Ingrid Lalike, shtetase shqiptar, e datëlindjes 02.04.1991, lindur në Vlorë, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 035946611 dhe me nr. personal J15402097A, Z. Dejvi Lalike shtetas shqiptar, i datëlindjes 02.06.1994, lindur në Vlorë, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 032974303 dhe me nr. personal J40602091U dhe Z. Ermand Hasalliu, shtetas shqiptar, i datëlindjes 10.10.1993, lindur në Kavajë, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 038565171 dhe me nr. personal J31010134I, me vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, hartuam këtë akt, me qëllim themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare, me emrin “**SPY SPEAKEASY**” SH.P.K.

Themeluesit, Znj. Ingrid Lalike, Z. Dejvi Lalike dhe Z. Ermand Hasalliu, bien dakord për hartimin dhe përmbajtjen e këtij Akti-Themelimi si më poshtë.

Neni 1
Emri – Selia

1.1 Shoqëria tregtare do të jetë e formës *shoqëri me përgjegjësi të kufizuar* dhe do të ketë emrin **“SPY SPEAKEASY SPEAKEASY” SH.P.K.** Shoqëria mund të përdorë dhe emrin tregtar **“SPY” SH.P.K.**

Selia e Shoqërisë është në adresën “Blv. Bajram Curri”, Pallatet “Agimi”, kati -1, shk 12, ZK 8270, Njësia 5, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Adresa e selisë së shoqërisë do të përcaktohet edhe në statutin e saj dhe mund të ndryshojë në të ardhmen me vendim të organeve vendimmarrëse përkatëse.

Neni 2
Funksionimi i shoqërisë

2.1 Shoqëria “SPY SPEAKEASY” SH.P.K do të punojë bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së ndershme. Funksionimi i shoqërisë “SPY SPEAKEASY” SH.P.K do të funksionojë bazuar në parimin e detyrimit të besnikërisë, në parimin e të drejtës së informimit, në parimin e ndalimit të abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë, në parimin e ndalimit të konkurrencës së pandershme, në parimin e sekretit tregtar.

2.2 Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë “SPY SPEAKEASY” SH.P.K do të jetë pa afat të përcaktuar.

2.3 Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik, përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar dhe solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, Themeluesit, Ortakët e shoqërisë “SPY SPEAKEASY” SH.P.K, nuk përgjigjen individualisht/personalisht apo solidarisht për detyrimet e kësaj të fundit ndaj personave të tretë (persona fizikë apo persona juridikë), por mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Vetëm shoqëria “SPY SPEAKEASY” SH.P.K, e pajisur sipas ligjit me personalitetin juridik të nevojshëm, është përgjegjëse për detyrimet e saj ndaj personave të tretë (persona fizikë apo persona juridikë).


2.4 Themeluesit do të japin kontributet e tyre në shoqëri, në para ose në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të parashikuara në statutin e shoqërisë.

Neni 3
Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë vijon:



2



- Investimi ne fushën bar-kafe, klub, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Ushtrimi i veprimtarise në fushën e tregtisë lokal bar-kafe, tregtim i pijeve alkoolike dhe freskuese, produkteve të ndryshme si erëza dhe preparate, ambalazheve, etj, import-eksport i kafes, pijeve alkoolike dhe freskuese.
- Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, rrjedh apo ka të bëjë me objektivat e renditura sa më lart. Për të arritur qëllimet e mësipërme, Shoqëria mund të ndërmarrë aktivitet tregtar, financiar, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në menyrë që të arrihet dhe përmbushet objekti i Shoqërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të ngushtohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 Kapitali - Përfaqësimi - Organet e Shoqërisë

4.1 Shoqëria do të ketë kapitalin të përcaktuar në statutin e saj, sipas kontributeve të Themeluesve të saj në para dhe/ose në natyrë.

4.2 Shoqëria do të përfaqësohet sipas rregullave të përcaktuara nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe sipas rregullave të statutit.

4.3 Rregullimi i hollësishëm i çështjeve të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë “SPY SPEAKEASY” SH.P.K, parashikohet në statutin e saj, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Bërë në Tiranë, më datë 07.02.2024, në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe secila me të njëjtën vlerë juridike.

THEMELUESIT E SHOQËRISË “SPY SPEAKEASY” SH.P.K

ZNJ. INGRID LALIKE

Z. DEJVI LALIKE

Z. ERMAND HASALLIU